



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASENIT LUMOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.3, datë 11.02.2026

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR VEPRIMTARI TË TJERA NË BRIGJET DHE SHTRATIN E BURIMIT UJOR, ME VENDNDODHJE: PËRROI GORRE, FSHATI PAPËR SOLLAK, BASHKIA ELBASAN, TË SUBJEKTIT "BASHKIA ELBASAN".**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Shkumbin,


VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës "Për autorizim për veprimtari të tjera në brigjet dhe shtratin e burimit ujor", të subjektit Bashkia Elbasan, me vendndodhje: Përroi Gorre, Fshati Papër Sollak, Bashkia Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Përroi Gorre

Koordinatat e vendndodhjes së burimit ujor (KRGJSH)

1. X=492344.36; Y=4555241.36; Z=702
2. X=492360.32; Y=4555241.94; Z=702
3. X=492366.35; Y=4555210.03; Z=702
4. X=492346.46; Y=4555208.35; Z=702





Lloji i burimit ujqor ku do të kryhet veprimtaria: Përroi Gorre

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: Ndërtimi i këmbëve të urës dhe speronave tip Bel

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBL SHKUMBIN**

**ILIR BEJTJA**

